



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
KORÇË**

PLANI STRATEGJIK I UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI" KORÇË 2022-2027



MIRATUAR ME VENDIM NR. 510, DATË 28.10.2021
NGA SENATI AKADEMIK

PËRMBAJTJA

Parathënie	1
------------------	---

GJENDJA AKTUALE E UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI”

1. Strategjia e zhvillimit dhe rëndësia	3
2. Metodologjia e planifikimit strategjik	4
3. Kuadri strategjik, misioni dhe vizioni	5
4. Historiku i zhvillimit të Universitetit “Fan S. Noli”	7
5. Struktura aktuale e Universitetit “Fan S. Noli”	8
6. Programet e Studimit	12
7. Studentët dhe ecuria akademike	15
8. Vlerësimi i cilësisë	19
9. Kërkimi shkencor	21

ANALIZA SWOT

10. Analiza Swot	25
------------------------	----

DREJTIMET E VEPRIMTARISË

11. Plani i detajuar i objektivave	27
• Organizimi institucional	27
• Mësimdhënia, kurrikulat, stafi akademik, sigurimi i brendshëm i cilësisë	28
• Infrastruktura, shërbime, promocioni	30
• Kërkimi shkencor dhe inovacioni	31
• Ndërkombëtarizimi i ofertës akademike	31
• Studentët	35
12. Rezultatet e pritshme nga objektivat	36
• Veprimtaria mësimore dhe vlerësimi i cilësisë	36
• Kërkimi shkencor	39
• Ndërkombëtarizimi i ofertës akademike	43
• Infrastruktura, promocioni dhe studentët	46

PARATHËNIE

Universiteti “Fan S. Noli” është një institucion i arsimit të lartë i cili përgjatë një periudhe pesëdhjetë vjeçare ka standardizuar një profil konkurrues akademik dhe shkencor në rrjedhën e zhvillimeve të arsimit universitar në Shqipëri. Ky universitet mund të konsiderohet si një nga polet më të rëndësishme të zhvillimit arsimor, ekonomik dhe social në juglindje të Shqipërisë. Duke u mbështetur mbi vlerat më të mira dhe traditën e ruajtur në kohë, aktualisht ky universitet synon të ofrojë standarde të qëndrueshme që orientojnë veprimtarinë akademike dhe shkencore drejt formave të reja të mësimdhënies, kërkimit dhe zhvillimit, për të qenë sa më pranë sfidave të të jetuarit në një shoqëri të hapur, me kërkesa në evoluim të vazhdueshëm. Vizioni i rritjes dhe zhvillimit të këtij institucioni është i orientuar drejt Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë, si një mundësi për të rritur profesionalizmin dhe partneritetin në ofertën e tij akademike.

Mbi këto premisa, Universiteti “Fan S. Noli” ka hartuar strategjinë e tij të zhvillimit 6-vjeçar me qëllim përcaktimin e prirjeve kryesore të zhvillimit, të shprehur në një seri objektivash strategjike të ndërlidhur me njëri-tjetrin dhe me palët e interesit të përfshira në proces.

Planifikimi Strategjik në vijim paraqet një përmbledhje të procesit dhe metodologjinë e përdorur, duke u nisur nga vlerësimi i situatës aktuale, përkufizimi i sfidave dhe mundësive të deritanishme, hartimi i piketave për një strategji të përbashkët të qëndrueshme, përcaktimi i rolit dhe funksionit të palëve të interesit. Këto elemente ilustrohen brenda kornizës së detajuar strategjike në planveprimin e ardhshëm gjashtë vjeçar të këtij universiteti.

Ky planifikim strategjik, është një dokument dinamik në përmirësim të vazhdueshëm dhe përfaqëson një përmbledhje të hapur, gjithëpërfshirëse, në reflektim të përditësimeve të nevojshme në kohë. Organet dhe autoritetet drejtuese mund ta përdorin këtë dokument si një memorandum që mat zbatueshmërinë graduale të parashikimeve akademike në përputhje me drejtimet kryesore të zhvillimit. Plani Strategjik që detajon Strategjinë e Zhvillimit, garanton vazhdimësinë dhe legjitimitetin e kësaj të fundit në rang institucional për periudha të caktuara vjetore.

GJENDJA AKTUALE E UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI”

1.

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT DHE RËNDËSIA

Ky dokument strategjik u hartua nga Rektorati i Universitetit “Fan S. Noli” mbi bazën e propozimeve të ardhura nga njësitë kryesore dhe njësitë bazë, mbi drejtimit kryesore të veprimtarisë për vitet 2022-2027. Kuadri në të cilin ofrohet arsimi i lartë në Shqipëri i përcakton universitetet jo thjesht si qendra mësimdhënieje, por si pole të rëndësishme të zhvillimit të rajoneve përkatëse, përmes mësimdhënies profesionale dhe kërkimit shkencor në përputhje me nevojat e tregut, të bashkëpunimit me palët e interesit, publikë dhe privatë, si dhe rritjes së partneritetit ndërkombëtar.

Strategjia e Zhvillimit e Universitetit “Fan S. Noli” është mbështetur në Statutin e këtij Universiteti, në Planin Strategjik të zhvillimit të tij në periudhën 2016-2020, në Strategjinë Kombëtare për Arsimin 2021-2026, si dhe në kërkesat e tregut të punës të rajonit të Korçës dhe me gjerë. Ajo gjithashtu vjen si rezultat i konsultimeve me pedagogë, studentë, sektorët përkatës të administratës, aktorët bazë të tregut të punës në secilën njësi kryesore dhe të raporteve të sigurimit të brendshëm të cilësisë në vitet pararendëse. Plani Strategjik që e ndjek është hartuar mbi detajimin e prioriteteve të kësaj Strategjie në një proces gjithëpërfshirës linjash, planesh veprimi dhe sigurimin e mbështetjes financiare për to.

Në këtë plan strategjik janë marrë parasysh planifikimet e bëra nga njësitë dhe fakultetet përkatëse, si dhe propozimet e dhëna nga Këshilli Studentor, me qëllim ruajtjen e përputhshmërisë strategjike me kërkesat e Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 40 pika 3, neni 38 pika b), neni 49 pika b). Ky plan parashikon mekanizma dhe instrumente që janë në gjendje të sigurojnë koherencë të plotë të objektivave strategjike dhe veprimeve të nevojshme për të arritur nivelet e pritshme të rezultateve.

2.

METODOLOGJIA E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

Planifikimi strategjik i Universitetit “Fan S. Noli” mbështetet në pikat e mëposhtme:

1. Analizimi i gjendjes aktuale të Universitetit “Fan S. Noli” dhe përpunimit i analizës SWOT mbi dritën e ndryshimeve dhe rezultateve të arritura nga objektivat strategjike të vendosur në planet e mëparshme afatshkurtër/afatgjatë të tij, përfshi këtu edhe diskutimet në njësitë bazë të sa mësipërme.
2. Përcaktimi i objektivave strategjike dhe atyre bazë në përputhje me treguesit e dalë nga analiza e sipërpërmendur.
3. Përputhja e qëllimeve të këtij plani me misionin dhe vizionin e Universitetit “Fan S. Noli”, duke u ndalur kryesisht në përmirësimin e veprimtarive kryesore institucionale: të edukimit, kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimit.
4. Përcaktimi i treguesve të veçantë të rezultateve sasiore, të lidhur me secilin objektiv bazë.
5. Diskutimi i hartës strategjike të krijuar në bashkëpunim me Rektoratin, Dekanatet dhe Këshillin Studentor, për të bërë ndryshimet e mundshme.
6. Miratimi i draftit përfundimtar të Planit Strategjik të Zhvillimit të Universitetit “Fan S. Noli” 2022-2027 nga Bordi i Administrimit dhe Senati Akademik.

3.

KUADRI STRATEGJIK, MISIONI DHE VIZIONI I UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI”

Ky dokument ka për qëllim të identifikojë prioritetet dhe objektivat kryesorë të zhvillimit të Universitetit “Fan S. Noli” në gjashtë vitet e ardhshme. Përveç analizës së gjendjes aktuale të kuadrit institucional, ky dokument fokusohet edhe mbi objektivat në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimeve akademike dhe ndërkombëtarizimin e këtyre të fundit, lidhjes së universitetit me tregun e punës dhe vlerësimin të situatës financiare, me synim krijimin e kushteve optimale për një zhvillim të qëndrueshëm në kohë të këtij institucioni.

Misioni i Universitetit “Fan S. Noli”:

“Fan S. Noli” është universitet publik dhe si i tillë ka mision kryesor të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve në fushat e ekonomisë, bujqësisë, shkencave humane dhe sociale, shkencave natyrore dhe shkencave të edukimit.

Vizioni i Universitetit “Fan S. Noli”:

Universiteti “Fan S. Noli” synon të jetë qendra më e rëndësishme e jetës akademike dhe shkencore në rajonit e Korçës, duke kontribuar drejtpërdrejt në zhvillimin arsimor, ekonomik dhe të qëndrueshëm të komuniteteve lokale, rajonale dhe më gjerë, nëpërmjet promovimit të programeve të studimit të njohura dhe të hapura për studentët dhe kërkuesit shkencorë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke u fokusuar në zhvillimin e aftësive profesionale dhe kërkimore, për t’u përballur denjësisht me kërkesat e tregut të punës.

Universiteti “Fan S. Noli” është:

- një institucion ku harmonizohet veprimtaria e studentëve, pedagogëve, kërkuesve shkencorë, stafeve administrative dhe teknike, në respekt të plotë të lirisë akademike në edukim dhe kërkim, të mendimit “ndryshe” dhe të përgjegjësisë sociale;
- vendi i krijimit, zhvillimit, përcjelljes dhe mbrojtjes së dijeve, që garanton kualifikimet në nivelet 5-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, si dhe forma të formimit të vazhduar;
- një institucion akademik publik, që përditëson në mënyrë të vazhdueshme mësimdhënien, punën kërkimore dhe transferimin e njohurive në të mirë të shoqërisë, në nivelin rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Nga sa më sipër, Universiteti "Fan S. Noli" e realizon misionin përmes këtyre objektivave:

- Të përgatisë specialistë të aftë për tregun e punës në fushat që mbulon në të gjitha programet e studimit, nëpërmjet mësimdhënies dhe praktikave mësimore, institucionale, profesionale, sportive dhe klinike;
- Të formojë studiues të rinj në fusha të ndryshme parësore, duke marrë parasysh drejtimit kryesore të zhvillimit të rajonit, nëpërmjet kërkimit shkencor dhe veprimtarisë botuese;
- Të plotësojë standardet për të garantuar procesin mësimor dhe atë shkencor në të gjitha ciklet e studimit që ai ofron;
- Të ndihmojë dhe të mbështesë zhvillimin kulturor e social-ekonomik në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, duke promovuar, organizuar dhe kryer shërbime kulturore dhe formuese;
- Të ofrojë mundësi të barabarta për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.
- Të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe në forcimin e sigurisë publike dhe kombëtare;
- Të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit;
- Të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë;
- Të zhvillojë të menduarit kritik e analitik, të kultivojë ndjenjën e përgjegjësisë dhe të angazhimit të njeriut, kulturave, ngjarjeve e çështjeve të ndryshme që kanë lidhje me individin dhe komunitetin;
- Të përgatisë profesionistë e qytetarë aktivë për shoqërinë demokratike shqiptare dhe për vlerat evropiane;
- Të kryejë studime shkencore për të zhvilluar programet e studimit të shkencave që lëvron dhe të ofrojë shërbime për zgjidhjen e problemeve më të rëndësishme që ka rajoni i Korçës dhe më gjerë;
- Të kryejë kualifikimin e vazhdueshëm të specialistëve të lartë të fushave të ndryshme, duke u kthyer në një qendër të rëndësishme kualifikimi dhe zhvillimi të teknologjive bashkëkohore.

Universiteti "Fan S. Noli" vepron në respekt të plotë:

- të të drejtave themelore të njeriut të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- të zhvillimit të lirë të studimit, kërkimit shkencor, si dhe bashkëpunimit në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare;
- të frymës bashkëpunuese me institucione qeveritare ose joqeveritare, biznese dhe ndërmarrje, institucione arsimore, duke ruajtur statusin e tij të pavarur nga çdo lloj orientimi ideologjik, politik apo fetar;
- të vlerave që lidhen me diversitetin etnik dhe social;
- të vizionit për të përgatitur profesionistë të denjë që do t'i shërbejnë një shoqërie më gjithëpërfshirëse, gjithmonë në ndryshim.

4.

HISTORIKU I ZHVILLIMIT I UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI”

Fillesat si institucion i arsimit të lartë, Universiteti “Fan S. Noli” i ka në 15 qershor 1971, kur me vendim të Këshillit të Ministrave, u hap Instituti i Lartë Bujqësor i Korçës. Në vitin e parë akademik 1971-1972 u regjistruan 43 studentë dhe deri në vitin 1991 ky Institut diplomoi rreth 1210 specialistë të bujqësisë. Mbi bazën e Institutit të Lartë Bujqësor, më 7 janar të vitit 1992 me vendim të Këshillit të Ministrave, u krijua Universiteti i Korçës, me emërtimin Universiteti Politeknik i Korçës, me tri njësi kryesore: Fakulteti i Bujqësisë, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti Pedagogjik. Në vitin 1994 me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 213, Universitetit të Korçës iu dha emri “Fan S. Noli”. Që prej atij viti Universiteti “Fan S. Noli” e ka zgjeruar strukturën e tij mësimore dhe administrative.

Në muajin maj të vitit 2015 presidenti i Republikës z. Bujar Nishani i akordoi Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës dekoratën e lartë “Nderi i Kombit” për kontribut të shquar në zhvillimin e arsimit, kulturës dhe shkencave.

Në 18 dhjetor të vitit 2001, Universiteti “Fan S. Noli” u nderua nga presidenti i Republikës z. Rexhep Mejdani me Urdhrin “Naim Frashëri” i Artë, për kontribut të rëndësishëm gjatë 30 viteve në përgatitjen e specialistëve të lartë të bujqësisë, ekonomisë, arsimit dhe shëndetësisë, për arritje me vlerë në punën kërkimore-eksperimentuese, për rol të veçantë në përhapjen e kulturës në qarkun e Korçës e më gjerë.

Në vitin 2017, gjatë procesit të Akreditimit Institucional, Universiteti “Fan S. Noli” u akreditua për një periudhë 5-vjeçare nga Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë. Aktualisht janë në proces akreditimi 9 programe studimi **tre prej të cilëve** u akredituan me vlerësime maksimale.

5.

STRUKTURA AKTUALE E UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI”

Në përmbushje të misionit të tij akademik, Universiteti “Fan S. Noli” ka këto struktura funksionale:

STRUKTURA AKADEMIKE NË NIVEL INSTITUCIONI:

- **Senati Akademik**

Senati Akademik është organi më i lartë kolegjal vendimmarrës i Universitetit “Fan S. Noli”. Ai ka aktualisht nëntëmbëdhjetë anëtarë, nga të cilët dy janë studentë. Senati Akademik vendos për çështje të rëndësishme të Universitetit në fushën e mësimit, kërkimit shkencor dhe administrimit, duke garantuar autonominë, lirinë akademike dhe të drejtat e studentëve.

- **Bordi i Administrimit**

Bordi i Administrimit është organi më i lartë drejtues/kolegjial administrativ. Ai garanton qëndrueshmërinë financiare të Universitetit “Fan S. Noli” dhe përmbushjen e misionit të tij. Bordi i Administrimit i Universitetit “Fan S. Noli” përbëhet nga shtatë anëtarë, ku njëri prej tyre zgjidhet nga votimi i drejtpërdrejtë i studentëve. Me propozim të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit miraton planin strategjik të zhvillimit, buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm, si dhe numrin e personelit në të gjitha nivelet e institucionit.

- **Rektorati**

Rektorati është organi kolegjal që drejtohet nga rektori dhe përbëhet nga rektori, zëvendësrektorët, administratori i institucionit dhe drejtuesit e njësive kryesore. Ai harton planin strategjik të zhvillimit të Universitetit “Fan S. Noli”, mbështetur në propozimet e njësive bazë dhe njësive kryesore të universitetit, si dhe ato të administratorit. Gjithashtu harton programin dhe raportin vjetor të veprimtarive mësimore-kërkimore, si dhe planin për bashkëpunimet dhe marrëveshjet që janë në kompetencë të tij.

- **Rektori**

Rektori është autoriteti më i lartë akademik i Universitetit “Fan S. Noli”, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare. Rektori zgjidhet nga anëtarët e asambleve të personelit akademik të njësive kryesore dhe studentët e Universitetit “Fan S. Noli”. Ai drejton Senatin Akademik dhe është anëtar i Konferencës së Rektorëve të universiteteve shqiptare.

- **Administratori**

Administratori i Universitetit “Fan S. Noli” është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të universitetit. Administratori është përfaqësues ligjor i Universitetit “Fan S.

Noli" për çështjet financiare dhe administrative. Ai është përgjegjës për hartimin, ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të buxhetit vjetor të Universitetit, si dhe përgjigjet për gjithë veprimtarinë ekonomike dhe financiare të universitetit.

- **Zv. Rektorët**

Universiteti "Fan S. Noli" ka dy zëvendësrektorë: Zëvendësrektori për mësimin dhe Zëvendësrektori për shkencën dhe marrëdhëniet me jashtë.

Zëvendësrektori për mësimin organizon dhe kontrollon punën mësimore në nivel universiteti, ndjek hartimin dhe zbatimin e planeve dhe programeve mësimore në njësitë kryesore dhe njësitë bazë, harton strukturën e vitit akademik për procesin mësimor në shkallë universiteti dhe raportin vjetor të veprimtarisë mësimore të Universitetit "Fan S. Noli", si dhe ia paraqet për miratim Rektorit.

Zëvendësrektori për shkencën dhe marrëdhëniet me jashtë ndjek dhe kontrollon ecurinë e zhvillimit të punës shkencore dhe projekteve në nivel universiteti, ndjek bashkëpunimin shkencor të njësive të Universitetit "Fan S. Noli" me institucione kërkimore-shkencore, universitete të tjera (brenda dhe jashtë vendit), firma, ndërmarrje prodhimi etj., si dhe organizon dhe harmonizon kryerjen e studimeve për zhvillimin perspektiv të tij në fushën e kërkimit.

- **Këshilli i Etikës**

Këshilli i Etikës është organ kolegjal i Universitetit "Fan S. Noli", i cili promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor, si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale. Këshilli i Etikës i Universitetit "Fan S. Noli" përbëhet nga 7 anëtarë (Rektori, një përfaqësues nga çdo njësi kryesore, një përfaqësues i studentëve dhe një përfaqësues nga personeli ndihmësakademik dhe administrativ). Ai funksionon në mënyrë kolegjinale.

STRUKTURAT AKADEMIKE NË NIVEL NJËSIE KRYESORE:

- Asambleja e personelit akademik;
- Dekanati (drejtohet nga dekani dhe përbëhet nga dekani, zëvendësdekani, drejtuesit e njësive bazë);
- Dekani;
- Zëvendësdekani/ët.

STRUKTURAT AKADEMIKE NË NIVEL NJËSIE BAZË:

Drejtuesi i departamentit është autoriteti drejtues akademik dhe përfaqësuesi i njësisë bazë. Ai drejton të gjithë veprimtarinë mësimore dhe shkencore në njësinë bazë, përgatit shpërndarjen e ngarkesës mësimore që miratohet në njësinë bazë, përgatit dhe i propozon organeve të emërtesës kurrikulat e studimeve të njësisë bazë, drejtime e profile të reja studimesh, projekte për programe të studimeve dhe të kërkimit shkencor etj., si dhe përgjigjet para dekanit e Dekanatis për mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në njësinë bazë.

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV:

- **Drejtoria Ekonomike**, e cila kryen administrimin në mënyrë të vazhdueshme të procesit të prokurimit, bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimet, si dhe menaxhon nevojat për transport dhe mirëmbajtje që ka Universiteti "Fan S. Noli".

- **Drejtoria e Financës**, e cila ndjek të gjithë veprimet financiare që lidhen me shpenzimet për veprimtarinë e Universitetit “Fan S. Noli”, pagesat e personelit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe të Burimeve Njerëzore, të shpenzimeve operative dhe investimeve në bashkëpunim me njësitë e tjera, si dhe bën mbylljen e bilancit vjetor për gjithë universitetin. Ajo gjithashtu ndjek dhe zbatimin e të gjitha procedurave financiare të realizimit të buxhetit të universitetit, të buxheteve të tjera (shërbime, donacione, projekte), mbajtjen e dokumentacionit përkatës në lidhje të ngushtë me organizmat financiarë shtetërorë në zbatim të akteve ligjore e nënligjore.
- **Njësia e Auditimit të Brendshëm**, e cila zbaton politikën dhe strategjinë e Universitetit “Fan S. Noli” për zhvillimin e vazhdueshëm të auditimit në arritjen e standardeve.

STRUKTURAT NDIHMËSAKADEMIKE ME KARAKTER ADMINISTRATIV NË NIVEL INSTITUCIONI:

- **Drejtoria e Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional:**
 - Sektori i studimeve dhe TIK;
 - Sektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni.
- **Drejtoria e Projekteve dhe Kërkimit Shkencor:**
 - Sektor i Projekteve dhe Kërkimit;
 - Sektori i Bashkëpunimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë;
 - Biblioteka Shkencore.
- **Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore:**
 - Sektori Juridik dhe Protokoll-Arkiva;
 - Sektori i Informacionit dhe Promocionit.
- **Kordinatori Erasmus+** bën koordinimin e projekteve për rritje kapacitetesh dhe për mobilitete të studentëve/stafit në kuadër të programit Erasmus+.
- **Koordinatori i Qendrës së Formimit të Vazhduar** ka për funksion organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive trajnuese dhe kualifikuese për mësuesit në shërbim. Drejtimet kryesore të punës së kësaj qendre përqendrohen në zhvillimin e shprehive të mësimdhënies dhe inovacionit në edukim, në mënyrat dhe praktikat e zhvillimit profesional të mësuesve etj.
- **Qendra e Inovacionit** ka për qëllim nxitjen e studentëve dhe të rinjve në përgjithësi drejt sipërmarrjes. Universiteti “Fan S. Noli” dhe Qendra e Inovacionit janë gjithmonë në kërkim të bashkëpunimeve të reja, me prioritet mbështetjen e të rinjve në këtë drejtim.
- **Shoqata Sportive Studentore e Universitetit “Fan S. Noli”**, me seli pranë godinës së Rektoratit, ka si qëllim të promovojë sportin në jetën studentore përmes zhvillimit të veprimtarive sportive në rang lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.
- **Këshilli Studentor** promovon dhe koordinon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të universitetit, si dhe në strukturat mësimore-kërkimore. Këshilli i Përgjithshëm i Studentëve i Universitetit “Fan S. Noli” dhe Këshilli i Studentëve i çdo Fakulteti zgjidhet me votim nga të gjithë studentët. Këshilli Studentor shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të universitetit.

STRUKTURAT NDIHMËSAKADEMIKE ME KARAKTER ADMINISTRATIV NË NIVEL NJËSIE KRYESORE JANË:

- Njësia për sigurimin e cilësisë;
- Sekretaria mësimore;
- Biblioteka e Fakultetit;
- Asistent i Dekanit.
- **Strukturat ndihmësakademike me karakter akademik në nivel njësie bazë:**
 - Laborantët;
 - EDE- Ekonomia Didaktike Eksperimentale.
- **Strukturat ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel njësie bazë:**
 - Sekretaritë në departament.

FAKULTETET DHE DEPARTAMENTET E UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI”

Sot, Universiteti “Fan S. Noli” përbëhet nga 4 Fakultete, të cilat janë organizuar në 15 departamente dhe 1 grup mësimor.

- **Fakulteti i Bujqësisë:**
 - Departamenti i Agronomisë;
 - Departamenti i Agrobiznesit;
 - Departamenti i Agroushqimit.
- **Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë:**
 - Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë;
 - Departamenti i Edukimit;
 - Departamenti i Gjuhëve të Huaja;
(me grupin mësimor të Gjuhësisë)
 - Departamenti i Historisë dhe Gjeografisë.
- **Fakulteti i Ekonomisë:**
 - Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit;
 - Departamenti i Menaxhimit;
 - Departamenti i Marketingut dhe Turizmit.
- **Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane:**
 - Departamenti i Shkencave Sociale;
 - Departamenti i Infermierisë;
 - Departamenti i Matematikës dhe Fizikës;
 - Departamenti i Biologjisë dhe Kimisë;
 - Departamenti i Informatikës.

6.

PROGRAMET E STUDIMIT

Aktualisht në Universitetin “Fan S. Noli” zhvillohen **60** Programe Studimi (54 aktivë dhe 6 joaktivë):

- 7 Programe Profesionale 2-vjeçare;
- 23 Programe Studimi të Ciklit të Parë (Bachelor);
- 23 Program Studimi të Ciklit të Dytë (3 MSC, 7 MP 120 kredite dhe 13 MP me 60 kredite),
- 1 Program Studimi i Ciklit të Tretë (Doktoraturë).

PROGRAMET E STUDIMIT (AKTIVE)

● Programe Studimi të Ciklit të Parë (Bachelor me 180 kredite):

1.	“Mësuesi për Arsimin Fillor KL I-VI”	Dep. i Edukimit
2.	“Mësuesi për Arsimin Parashkollor”	Dep. i Edukimit
3.	“Edukim Fizik dhe Sporte”	Dep. i Edukimit
4.	“Gjuhë-Letërsi”	Dep. i Gjuhës dhe Letërsisë
5.	“Histori-Gjeografi”	Dep. i Historisë dhe Gjeografisë
6.	“Gjuhë Angleze”	Dep. i Gjuhëve të Huaja
7.	“Agroushqim”	Dep. i Agroushqimit
8.	“Menaxhim Agrobiznesi”	Dep. i Agrobiznesit
9.	“Inxhinieri Agronomike”	Dep. i Agronomisë
10.	“Financë-Kontabilitet”	Dep. i Financës dhe Kontabilitetit
11.	“Ekonomiks”	Dep. i Financës dhe Kontabilitetit
12.	“Menaxhim”	Dep. i Menaxhimit
13.	“Informatikë Biznesi”	Dep. i Menaxhimit
14.	“Administrim Biznesi në Marketing”	Dep. i Marketingut dhe Turizmit
15.	“Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje”	Dep. i Marketingut dhe Turizmit
16.	“Filozofi-Sociologji”	Dep. i Shkencave Sociale
17.	“Administrim dhe Politika Sociale”	Dep. i Shkencave Sociale
18.	“Matematikë-Informatikë”	Dep. i Matematikës dhe Fizikës
19.	“Matematikë-Fizikë”	Dep. i Matematikës dhe Fizikës
20.	“Infermier i Përgjithshëm”	Dep. i Infermierisë
21.	“Mami”	Dep. i Infermierisë
22.	“Biologji-Kimi”	Dep. i Biologjisë dhe Kimisë
23.	“Teknologji Informacioni”	Dep. i Informatikës

● **Programe Profesionale 2-vjeçare (120 kredite):**

1.	“Edukim për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme”	Dep. i Edukimit
2.	“Mbështetës Zyre për Komunikimin, Bibliotekë dhe Arkivë”	Dep. i Gjuhës dhe Letërsisë
3.	“Menaxhim Biznesi Bujqësor”	Dep. i Agrobiznesit
4.	“Menaxhim Veterinar”	Dep. i Agroushqimit
5.	“Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve”	Dep. i Agronomisë
6.	“Asistent Menaxher”	Dep. i Menaxhimit
7.	“Shërbim Social”	Dep. i Shkencave Sociale

● **Programe Studimi të Ciklit të Dytë (Master Profesional me 120 kredite) (mësuesi):**

1.	“Master Profesional” në “Mësues për Arsimin Fillor”	Dep. i Edukimit
2.	“Master Profesional” në “Mësues për Gjuhën Shqipe dhe Letërsi”	Dep. i Gjuhës dhe Letërsisë
3.	“Master Profesional” në “Mësues i Gjuhës Angleze”	Dep. i Gjuhëve të Huaja
4.	“Master Profesional” në “Mësues në Histori dhe Gjeografi”	Dep. i Historisë dhe Gjeografisë
5.	“Master Profesional” në “Mësues në Shkenca Sociale”	Dep. i Shkencave Sociale
6.	“Master Profesional” në “Mësues në Matematikë dhe Inf-Fizikë”	Dep. i Matematikës dhe Fizikës
7.	“Master Profesional” në “Mësues në Biologji dhe Kimi”	Dep. i Biologjisë dhe Kimisë

● **Programe Studimi të Ciklit të Dytë (Master Profesional me 60 kredite):**

1.	“Mësues në Arsimin Special dhe Gjithpërfshirjen”	Dep. i Edukimit
2.	“Cilësia dhe Siguria Ushqimore”	Dep. i Agroushqimit
3.	“Zhvillim i Integruar Rural”	Dep. i Agrobiznesit
4.	“Inxhinieri Agrare, Profil Hortikulture”	Dep. i Agronomisë
5.	“Financë-Kontabilitet”	Dep. i Financës dhe Kontabilitetit
6.	“Bankë dhe Sigurime”	Dep. i Financës dhe Kontabilitetit
7.	“Administrim Biznesi”	Dep. i Menaxhimit
8.	“Marketing”	Dep. i Marketingut dhe Turizmit
9.	“Marketingu Dixhital”	Dep. i Marketingut dhe Turizmit
10.	“Menaxhim i turizmit, atraksioneve dhe eventeve”	Dep. i Marketingut dhe Turizmit
11.	“Administrim Publik”	Dep. i Shkencave Sociale
12.	“Infermieristikë”	Dep. i Infermierisë
13.	“Sisteme Moderne të Telekomunikacionit dhe Tekn. e Intern.”	Dep. i Informatikës

● **Programe Studimi të Ciklit të Dytë (Master i Shkencave me 120 kredite):**

1.	“Master i Shkencave” në “Kulturë, Media dhe Editim”	Dep. i Gjuhës dhe Letërsisë
2.	“Master i Shkencave” në “Financë”	Dep. i Financës dhe Kontabilitetit
3.	“Master i Shkencave” në “Filozofi Sociale”	Dep. i Shkencave Sociale

● **Programe Studimi të Ciklit të Tretë (Doktoraturë):**

1.	“Doktoraturë” në “Hortikulturë e Qëndrueshme”	Dep. i Agronomisë
----	---	-------------------

PROGRAMET E STUDIMIT (JOAKTIVE):

● **Programe Studimi të Ciklit të Parë (Bachelor me 180 kredite):**

1.	“Gjuhë dhe Kulturë Frënge”	Dep. i Gjuhëve të Huaja
2.	“Mjekësi e Bimëve dhe Hortikulturë”	Dep. i Agronomisë
3.	“Biznes dhe Tregti”	Dep. i Marketingut dhe Turizmit

● **Programe Studimi të Ciklit të Dytë (Master Profesional me 120 kredite) (mësuesi):**

1.	“Mësimdhënie për mësuesit e shkollave profesionale”	Dep. i Edukimit
----	---	-----------------

● **Programe Studimi të Ciklit të Dytë (Master Profesional me 60 kredite):**

1.	“Guidë Turistike”	Dep. i Marketingut dhe Turizmit
----	-------------------	---------------------------------

● **Programe Studimi të Ciklit të Dytë (Master i Shkencave me 120 kredite):**

1.	“Master i Shkencave” në “Mjekësi Bimore”	Dep. i Agronomisë
----	--	-------------------

7.

STUDENTËT DHE ECURIA AKADEMIKE

STUDIMI I ECURISË AKADEMIKE (2016-2020)

Në studim të ecurisë së fushave prioritare të Planit Strategjik të Zhvillimit të Universitetit "Fan S. Noli", *përmirësimi i cilësisë së programeve të studimit, çelja dhe riorganizimi i programeve të studimit, përmirësimi i kurrikulës me bazë rezultatet e të nxënësve, përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies*, në vijim paraqitet vijueshmëria e elementëve përbërës të veprimtarisë mësimore.

Pranimet e reja dhe programet e studimit në periudhën 2016-2020

Aktualisht në Universitetin "Fan S. Noli" vazhdojnë studimet rreth **3500** studentë nga të gjitha rrethet e Shqipërisë dhe nga trojet shqiptare.

Në Universitetin "Fan S. Noli" japin mësim **157** pedagogë efektivë, prej të cilëve **5** profesorë, **29** profesorë të asociuar, **75** doktorë shkencash, **7** docentë dhe **41** të tjerë. Në vitet akademike 2016-2020 numri i pedagogëve me kohë të pjesshme ka variuar mes **96** dhe **136**.

Viti Akademik	2016-2017	2017-2018	2018-2019	2019-2020	2020-2021
Nr. PAE	156	157	156	161	158
Raporti staf/student	1/30	1/30	1/29	1/22	1/21

Raporti staf/student nga viti në vit është ndikuar nga numri i përgjithshëm i studentëve dhe për çdo program studimi ka rezultuar brenda kriterëve (sipas VKM-së përkatëse për standardet e raportit staf/student).

Pranimet e reja për periudhën 2016-2020 kanë pësuar ndryshime të vazhdueshme si në drejtimin sasior, ashtu edhe në atë cilësor. Ndryshimet e akteve nënligjore që lidhen me kriterin e notës mesatare, si dhe rënia e numrit të maturantëve nga viti në vit ka çuar në një ndryshim të vazhdueshëm të numrit të studentëve në shkallë IAL-je. Kjo ka qenë arsyeja kryesore që ka ndikuar në prurjet e çdo viti, edhe pse veprimtaritë promovuese janë zhvilluar rregullisht për çdo vit.

Viti Akademik	2016-2017	2017-2018	2018-2019	2019-2020	2020-2021
Pranimet në të gjitha ciklet	1491	1474	1583	1342	1338

Nga të dhënat e pranimeve të reja për 5 vite akademike vihet re një rënie e pranimeve nga fillimi në përfundim të periudhës, me përjashtim të vitit akademik 2018-2019, për arsye të aktivizimit të 14

programeve të reja të studimit. Në vitet në vazhdim vijon rënia e numrit të studentëve duke u reflektuar edhe në numrin e përgjithshëm të studentëve sipas tabelës së mëposhtme.

Numri i përgjithshëm i studentëve gjatë periudhës 2016-2020:

Viti Akademik	2016-2017	2017-2018	2018-2019	2019-2020	2020-2021
Numri i studentëve	4750	4726	4549	3629	3334

Numri i studentëve të diplomuar gjatë periudhës 2016-2020:

Viti Akademik	2016-2017	2017-2018	2018-2019	2019-2020
Diplomime	1140	1231	1413	1341

Gjatë vitit akademik 2019-2020, Universiteti “Fan S. Noli” u përball me një sfidë të vështirë për sa i përket ecurisë së procesit mësimor. Izolimi si rezultat i pandemisë nga virusi Covid-19, krijoi kërkesa të reja për mënyrën e zhvillimit të mësimit duke u bazuar kryesisht te mësimdhënia online. Mbështetur në përvojat më të mira të sjella nga stafi akademik, si dhe nevojat për mënyra të reja mësimdhënieje, u morën masa të rëndësishme për zhvillimin e mësimit nëpërmjet platformave të mësimit online. Pas periudhës së parë të zhvillimit të mësimit online (semestri i dytë i vitit akademik 2019-2020) u morën të gjitha masat për zbatimin e një platforme të unifikuar për të gjithë stafin akademik përpara fillimit të vitit të ri akademik 2020-2021.

Fillimi i vitit të ri akademik 2020-2021 e gjeti stafin akademik të përgatitur për të zhvilluar mësim nëpërmjet platformave online.

- Konkretisht nëpërmjet një projekti u instalua dhe u zhvilluan trajnime për mundësitë që ofron paketa MIRCOSOFT OFFICE 365 në të cilën përfshihet edhe platforma MICROSOFT TEAMS. I gjithë viti akademik u zhvillua mbi bazën e kësaj platforme si një mënyrë e suksesshme që mund të përdoret edhe në vazhdim.
- U mundësua abonimi në bibliotekën online.
- U vu në zbatim projekti “Cleanscore” si një format vlerësimi për studentët.

Programe të reja studimi, riorganizime (prijet):

Hapja e programeve të reja të studimit apo riorganizimi i tyre është një proces i vazhdueshëm i zhvillimit të Universitetit “Fan S. Noli” duke iu përgjigjur nevojave të tregut për profesionet e kërkuara nga njëra anë dhe përditësimit të kërkesave sipas ndryshimeve që pëson tregu i punës nga ana tjetër.

Ndryshimet e ligjit për arsimin e lartë në vitin 2015 dhe nevojat e reja të tregut të punës e çuan Universitetin “Fan S. Noli” drejt kërkesës për hapjen/riorganizimin e programeve të studimit. Në zbatim të ligjit të ri të arsimit të lartë u përshtatën programet e studimit të ciklit të dytë Master, nga 90 kredite në 60 ose 120 kredite dhe në vitin 2019 u mor miratimi nga MASR (Shkresë MASR nr. 1287/1, datë 15.03.2019).

Në zbatim të strategjisë për zhvillimin e Universitetit "Fan S. Noli" është aplikuar çdo vit në MASR për hapjen/riorganizimin e programeve të studimit, konkretisht:

Në vitin 2017 u aplikua dhe u mor miratimi nga MASR për 2 programe studimi:

1.	"Master Profesional" në "Administrim Publik"
2.	Program profesional 2-vjeçar "Edukim për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme"

Në vitin 2018 u aplikua dhe u mor miratimi nga MASR për 14 programe studimi:

1.	Program Profesional 2-vjeçar "Shërbim Social"
2.	Program Profesional 2-vjeçar "Mbështetës Zyre për Komunikimin, Bibliotekë dhe Arkiv"
3.	Program Profesional 2-vjeçar "Asistent Menaxher"
4.	Program Profesional 2-vjeçar "Teknika të prodhimit të farave dhe fidanëve"
5.	Program Profesional 2-vjeçar "Menaxhim Veterinar"
6.	Program Profesional 2-vjeçar "Menaxhim Biznesi Bujqësor"
7.	"Bachelor" në "Biznes dhe Tregti"
8.	"Bachelor" në "Informatikë Biznesi"
9.	"Bachelor" në "Ekonomiks"
10.	"Master Profesional" në "Bankë dhe Sigurime" (60 kredite)
11.	"Master Profesional" në "Guidë Turistike" (60 kredite)
12.	"Master Profesional" në "Inxhinieri Agrare", Profili Hortikulturë (60 kredite)
13.	"Master Profesional" në "Cilësia dhe Siguria Ushqimore" (60 kredite)
14.	"Master i Shkencave" në "Kulturë, Media dhe Editim"

Hapja e programeve të reja për këtë vit akademik kishte për qëllim rritjen e numrit të studentëve për departamentet apo fakultetet që u rrezikuan si pasojë e rënies së numrit të studentëve nga vendosja e notës mesatare sipas VKM-së përkatëse.

Në vitin 2019 u aplikua për 2 programe studimi:

1.	"Bachelor" në "Edukim Fizik dhe Sporte"
2.	"Master Ekzekutiv" në "Drejtimi në Arsim"

nga të cilat u miratua nga MASR "Bachelor" në "Edukim Fizik dhe Sporte".

Në vitin 2020 u aplikua për 9 programe studimi (hapje/riorganizim):

1.	Program Profesional 2-vjeçar "Administrator në shitje dhe shërbime"
2.	Program Profesional 2-vjeçar "Sisteme dhe rrjeta kompjuterike"
3.	Program Profesional 2-vjeçar "Asistent kontabilist"
4.	"Bachelor" në "Media dhe kulturë filologjike"
5.	"Bachelor" në "Shkencat e edukimit fillor" (riorganizim)
6.	"Master Profesional" në "Edukim special për gjithëpërfshirjen"
7.	"Master Profesional" në "Edukim dhe shërbim social"
8.	"Master i Shkencave" në "Teknologjitë e informacionit në biznes"
9.	"Master Ekzekutiv" në "Drejtimi në Arsim"

Theksojmë se MASR nuk miratoi asnjë nga këto programe të propozuara.

Në vitin 2021 u aplikua për 3 programe studimi dhe për riorganizimin e 3 programeve aktive:

1.	Program profesional 2- vjeçar "Administrator në shitje dhe shërbime" (Program i ri)
2.	“Bachelor” në “Menaxhim Agrobiznesi” (riorganizim)
3.	“Bachelor” në “Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje” (riorganizim)
4.	"Master profesional" në "Marketingu Digjital" (Program i ri)
5.	"Master Profesional" në "Mësuesi për Arsimin Special dhe Gjithëpërfshirjen" (Program i ri)
6.	“Master Profesional” në “Menaxhimi i Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve” (riorganizim)

Nga një vështrim i përgjithshëm i zhvillimit të kurrikulave për vitet e fundit, vihet re se njësitë bazë po fokusohen gjerësisht në kërkesat për ndryshime apo hapje programesh të reja sipas nevojave të tregut të punës dhe prioriteteve kombëtare. Gjithashtu duke pasur parasysh ndryshimet ligjore janë përpjekur të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe të maturantëve për të ndjekur një nga programet e studimit që ofron Universiteti “Fan S. Noli”.

8.

VLERËSIMI I CILËSISË

AKREDITIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Procesi i akreditimit e ka vendosur Universitetin “Fan S. Noli” përballë një sfide në përmbushje të kërkesave të legjislacionit në fuqi. Rëndësia e këtij procesi lidhet me përmbushjen e standardeve në sigurimin e cilësisë nëpërmjet mekanizmave të jashtëm dhe të brendshëm, duke përfshirë një sërë aktorësh në këtë proces.

Universiteti “Fan S. Noli” është përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në gjitha proceset për sigurimin e brendshëm të cilësisë, por si pasojë e ndryshimeve të legjislacionit, në janar të vitit 2017 u përfshi në procesin e akreditimit institucional duke iu nënshtruar vlerësimit të ekspertëve në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Akreditimit QAA. Ky proces shërbeu për të vlerësuar cilësinë e ofertës akademike të Universitetit “Fan S. Noli” dhe evidentoi hapësirat për përmirësim në shkallë IAL-je, dhe jo vetëm, duke i hapur rrugë vlerësimit të programeve të studimit.

Pas vlerësimit përfundimtar nga Bordi i Akreditimit (VBA nr. 65, datë 21. 09. 2017), i cili e akreditoi Universitetin “Fan S. Noli” për **5 vite**, u morën masat për përmbushjen e rekomandimeve dhe vijoi puna për akreditimin e programeve të studimit.

Me vendim Rektorati 282, datë 21. 5. 2019 filloi procesi i akreditimit për 9 programe studimi të ciklit të parë “Bachelor” dhe programe studimit të karakterit profesional 2-vjeçar:

1.	“Bachelor” në “Agroushqim”
2.	“Bachelor” në “Inxhinieri Agronomike”
3.	“Bachelor” në “Gjuhë Angleze”
4.	“Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Fillor KL I-VI”
5.	“Bachelor” në “Financë - Kontabilitet”
6.	“Bachelor” në “Menaxhim”
7.	“Bachelor” në “Administrim dhe Politika Sociale”
8.	“Bachelor” në “Biologji- Kimi”
9.	Program Profesional 2-vjeçar “Edukim për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme”

Njësitë bazë u përfshinë në këtë proces të ri duke angazhuar gjithë stafin dhe studentët në vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë së programeve specifike të studimit. Të gjitha programet e studimit e kanë përfunduar këtë proces, ku disa prej tyre kanë marrë edhe vlerësim maksimal nga ekspertët e jashtëm.

- “Bachelor” në “Menaxhim” (Akredituar me **6 vite**);
- “Bachelor” në “Biologji- Kimi” (Akredituar me **6 vite**);
- “Bachelor” në “Gjuhë Angleze” (Akredituar me **5 vite**).

Të gjitha, nga sa më sipër, i kanë shërbyer Universitetit “Fan S. Noli” si institucion dhe njësisive bazë për të vlerësuar ofertën akademike, për të evidentuar pikat e forta, pikat e dobëta, rekomandimet dhe për të përmirësuar edhe më tej këtë ofertë nëpërmjet masave konkrete.

Rekomandimet dhe detyrat e lëna nga grupi i parë i programeve të studimit për akreditim po merren parasysh nga njësitë bazë në grupin e dytë të programeve të studimit (13 programe studimi) të aplikuara për akreditim gjatë muajit prill-maj 2021:

1.	“Bachelor” në “Gjuhë-Letërsi”
2.	“Bachelor” në “Administrim Biznesi në Marketing”
3.	“Bachelor” në “Histori-Gjeografi”
4.	“Bachelor” në “Matematikë-Informatikë”
5.	“Bachelor” në “Matematikë-Fizikë”
6.	“Bachelor” në “Teknologji Informacioni”
7.	“Master Profesional” në “Cilësia dhe Siguria Ushqimore”
8.	“Master Profesional” në “Inxhinieri Agrare, Profili Hortikulturë”
9.	“Master Profesional” në “Financë-Kontabilitet”
10.	Program Profesional 2-vjeçar “Shërbim Social”
11.	Program Profesional 2-vjeçar “Asistent Menaxher”
12.	Program Profesional 2-vjeçar “Menaxhim Veterinar”
13.	Program Profesional 2-vjeçar “Menaxhim Biznesi Bujqësor”

Bazuar në VBA nr. 65, datë 21. 09. 2017 “Për akreditimin institucional të Universitetit “Fan S. Noli” periudha e vlefshmërisë së akreditimit institucional është deri më 30. 09. 2022.

Bazuar në “Manualin për procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të LAL-ve dhe programeve të studimit”, aplikimi për akreditim periodik do të zhvillohet në muajin tetor 2021. Puna përgatitore për akreditimin periodik ka filluar duke koordinuar punën për mbledhjen e dokumentacionit mbështetës së raportit të vlerësimit të brendshëm dhe përkthimin e tyre nga strukturat në Rektorat. Pas evidentimit të dokumentacionit kryesor do të hartohet edhe plani specifik i veprimit për koordinimin e punës në vazhdim të procesit.

Në tabelën që vijon janë paraqitur të dhënat për akreditimet e programeve të studimit aktuale:

Programi i Studimit	Gjithsej	Akredituar	Aplikim për akreditim	Të pa akredituar
Program Profesional	7	1 / 14%	4 / 56%	2 / 30%
Bachelor	26	8 / 31%	6 / 23%	12 / 46%
Master Profesional (120 kredite)	8	—	—	8 / 100%
Master Profesional (60 kredite)	14	—	3 / 21%	11 / 79%
Master i Shkencave	4	—	—	4 / 100%
Doktoraturë	1	—	—	1 / 100%

9.

KËRKIMI SHKENCOR

Universiteti “Fan S. Noli” e konsideron kërkimin shkencor, si pjesë të pandarë të veprimtarisë së tij si institucion i arsimit të lartë dhe njëkohësisht si pjesë e kualifikimit të mëtejshëm të stafit akademik.

Stafi akademik gjatë periudhës 2016-2020

Stafi akademik i Universitetit “Fan S. Noli” ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të rritur nivelin e kualifikimit. Për çdo vit akademik Universiteti ka pësuar ndryshime të kualifikimeve të stafit akademik me kohë të plotë duke rritur nivelin e kualifikimit nëpërmjet marrjes së Titujve/Gradave shkencore.

Tituj dhe grada të fituara nga stafi akademik

Viti Akademik	2016-2017	2017-2018	2018-2019	2019-2020	2020-2021
Dr./Phd	3	8	9	4	1
Prof. as. dr.	3	—	—	—	1

Në vitet në vazhdim kualifikimet kanë vijuar në nivelin e gradave shkencore për shkak të ngrirjes së funksionimit të komisioneve për dhënien e titujve në IAL-të shqiptare.

Aktualisht stafi reflekton kualifikimet si më poshtë:

Titulli/grada	Msc.	Dr.	Doc.	Phd.	Prof.as.dr.	Prof.dr.
Numri	39	73	4	5	28	6
Përqindja	25 %	47 %	3 %	3 %	18 %	4 %


Veprimtaritë shkencore me karakter rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, të organizuara nga UNIKO dhe njësitë përkatës gjatë periudhës 2016-2020 janë 78, nga të cilat 4 Konferenca Shkencore Ndërkombëtare, 11 Konferenca Shkencore Kombëtare, 14 promovime/ prezantime librash, 9 seminare shkencore, 18 ligjërata, 2 workshope, 16 tryeza të rrumbullakta, 4 forume shkencore.

Nga të dhënat e mbledhura nga analizat e veprimtarive vjetore të secilës njësi, rezulton se në peirudhën 2016-2020:

- Stafi akademik i FB ka një rënie në pjesëmarrjet në Konferenca ndërkombëtare, ndërkohë që shihet një rritje e numrit të pjesëmarrjeve në simpoziume shkencore, seminare dhe trajnime brenda fakultetit.
- Stafi akademik i FEF ka një rënie në pjesëmarrjet në Konferenca ndërkombëtare, ndërkohë që shihet një rritje e larmishmërisë së veprimtarive shkencore me pjesëmarrjen në dy kongrese ndërkombëtare

- Stafi akademik i FE ka një rënie në pjesëmarrjet në Konferenca ndërkombëtare, ndërkohë që shihet një rritje e larmishmërisë së veprimtarive shkencore me pjesëmarrjen kryesisht në tryeza diskutimi dhe leksione të hapura me pjesëmarrje të studentëve.
- Stafi akademik i FSHNSHH ka pasur një qëndrueshmëri të dukshme në pjesëmarrjen në veprimtaritë shkencore, po ashtu edhe në organizimet brenda fakultetit.

Botime Un. “Fan S. Noli”	Viti 2017-2018	Viti 2018-2019	Viti 2019-2020
Revista brenda vendit	106	12	15
Revizta jashtë vendit	77	33	58
Revista me faktor impakti	6	16	2
Libra / Monografi	6	—	15



Në po këtë periudhë, UNIKO ishte pjesë e konsorciumit të **11 projekteve ndërkombëtare** Erasmus+ KA2 dhe **4 marrëveshje mobilitetesh Erasmus + KA1**, përmes të cilave është bërë i mundur mobiliteti i pedagogëve dhe studentëve, si dhe është modernizuar infrastruktura mësimore.

Buletini i Universitetit “Fan S. Noli” është organi që boton dhe promovon veprimtarinë kërkimore-shkencore të këtij institucioni. Ai është i pajisur me ISSN: 2078-7111, e cila e identifikon si organ publikimesh shkencore. Në periudhën 2016-2020, buletini ka dalë në publikim si botim i veçantë nga secila njësi kryesore e universitetit, përkatësisht: 8 botime të veçanta të Vjetarit “FEF”, 4 botime të veçanta të “Natyra dhe kultura” dhe 1 botim i veçantë “Studime ekonomike”. Fushat kryesore të serive të shkencave të zbatuara janë: bujqësi, ekonomi, matematikë, ndërkohë që fushat e serisë së shkencave shoqërore përfshijnë: historinë, gjuhësinë, letërsinë, mësimdhënien, psikologjinë dhe arsimin.

Nga viti 2019 buletini, si dhe botimet e veçanta të tij, janë publikuar online, në format PDF, me qëllim përdorimin nga një lexues më i gjerë, përfshi edhe studentët, si literaturë mbështetëse për punimet e diplomave, apo për specializime të mëtejshme, në linkun: <http://unkorce.edu.al/botime-elektronike>

	Viti	Fa. Ekonomik	Fa. i Edukimit dhe Filologjisë	Fa. Bujqës.	Fa. i Shkencave Natyrore
1.	2020		“Vjetari shkencor FEF”, Nr.7		
2.	2019		“Vjetari shkencor FEF”, Nr. 6		
3.	2019	“Studime ekonomike”, Vol. 1			“Natyra dhe kultura”, Nr. 3
4.	2018		“Vjetari shkencor FEF”, Nr. 5/1		
5.	2018		“Vjetari shkencor FEF”, Nr. 5/2		
6.	2018				“Natyra dhe kultura”, Nr. 2
7.	2018				“Natyra dhe kultura”, Nr. 1
8.	2018		“Vjetari shkencor FEF”, Nr. 4		
9.	2017		“Vjetari shkencor FEF”, Nr. 3		
10.	2017		“Vjetari shkencor FEF”, Nr. 2		
11.	2016		Buletini Shkencor (seria e shkencave shoqërore)		

Në përgjithësi ka një qëndrueshmëri sa i takon botimit periodik të tij dhe një shpërndarje po ashtu të qëndrueshme në nivel fakulteti; këta të fundit kanë botuar kryesisht punimet e aktiviteteve shkencore të organizuara nga vetë njësia. Gjatë këtyre viteve kanë munguar botimet në Buletinin UNIKO të pedagogëve të FB dhe të studimeve në fushat e shkencave bujqësore. Në numrat e fundit të Buletinit është nxitur botimi i artikujve në gjuhën angleze në mënyrë që të krijohet terreni i nevojshëm për aplikim pranë qendrave ndërkombëtare që japin të drejtën e faktorit të impaktit.

Biblioteka e Universitetit “Fan S. Noli” sot ka në fondin e vet rreth 30.000 libra me mbi 12.000 tituj që u përkasin fushave të ndryshme, por më tepër të përqëndruara në ato të ekonomisë së tregut, agronomisë dhe psiko-pedagogjisë. Ky fond është aktualisht i shpërndarë në pesë mjedise dhe përkatësisht në:

- Biblioteka Shkencore pranë Rektoratit;
- Biblioteka e Fakultetit Ekonomik;
- Biblioteka e Fakultetit të Bujqësisë;
- Biblioteka e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë;
- Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane.

Shërbime:

- Online library” e cila shërben si një formë database ku studentit i serviren gjithë titujt e fondit që biblioteka disponon, duke mundësuar kushte kërkimi dhe studimi si në universitetet më të mira në vendet e tjera evropiane <https://172.16.0.8/login.aspx>
- katalogu me URL i faqeve në të cilat ne kemi aksesueshmëri, si p.sh. ajo e Bankës së Shqipërisë, ku përveç shkëmbimit të materialeve, materiali vjen dhe i aksesueshëm online për shfletim dhe studim. <https://www.bankofalbania.org/Botime/>
- biblioteka online ProQuest <https://www.search.proquest.com/pqrl/?accountid=143248>
- biblioteka digjitale “U Library” ofron një numër të madh burimesh elektronike mbi 170.000 libra, mbi 70 milion artikuj akademikë, si dhe artikuj gazetash të ndryshme, një numër i pakufizuar hartash dhe mjete të tjera audiovizive.

https://search.ebscohost.com/login.aspx?direct=true&scope=site&site=eds-live&authtype=custuid&groupid=main&profile=eds&custid=ns083234&bquery=&search_prefix=&uquery

- krijimi i databazës online, skedimi dhe klasifikimi i fondit të bibliotekave nëpërmjet programit “KOHA”.

Digjitimi i “Fondit Nolian”; fond i dhuruar para pesë vjetësh universitetit aktualisht në proces skanimi dhe skedimi, në mënyrë që t`u vihet lehtësisht në dispozicion personave të interesuar, duke u bërë kështu pjesë e fondit të Bibliotekës Shkencore të Universitetit.

Laboratorët në dispozicion të kërkimit shkencor dhe mësimdhënies:

Laborator Didaktik për punë kërkimore:	Laborator Didaktik:
Laborator i Agrokimisë	Laboratori i Mbrojtjes së Bimëve
Laboratori i Pedologjisë	Laboratori i Pemëtarisë
Laboratori Digjital i Fonetikës	Laboratori i Perimtarisë
Laboratori i Hoteleri-Turizëm	Laboratori i Fitoteknisë
Laboratori i Kimisë dhe i Kimisë Analitike	Laboratori Digjital i Trajnimit të Gjuhëve të Huaja
Laboratori i Biologjisë dhe Biologjisë Molekulare	Laboratori i Kompjuterizimit Financiar
Laboratori i Fizioterapisë	Laboratori i Infermieristikës
Laboratori i Optikës	Laboratori i Fizikës së Përgjithshme (Elektromagnetizëm)
Laboratori i Informatikës I/II	Laboratori i Fizikës së Përgjithshme (Mekanikë)

10.

ANALIZA SWOT

Pikat e forta të Universitetit “Fan S. Noli”:

1. Institucioni i vetëm i arsimit të lartë që operon në mënyrë të qëndrueshme në zonën jug-lindore të Shqipërisë për një periudhë 50-vjeçare, me akreditim institucional 5-vjeçar;
2. Fillimi me sukses i procesit të akreditimit të Programeve të Studimit;
3. Pozita gjeografike në pikëlidhje të tre shteteve (Shqipëri-Greqi-Maqedoni e Veriut);
4. Mjedise, infrastrukturë e teknologjisë së informacionit bashkëkohore dhe bibliotekë shkencore për një zhvillim normal të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore;
5. Infrastrukturë laboratorike me drejtëm didaktik dhe kërkimor;
6. Numri i konsiderueshëm i lartë i Institucioneve të Arsimit të Mesëm dhe të Ulët në Rajonin e Korçës (rreth 300), që favorizon Programet e Studimit të profilit të mësuesisë;
7. Staf akademik dhe administrativ i qëndrueshëm në masën 99% në katër vitet e fundit;
8. Fusha studimi dhe kërkimi të qëndrueshme dhe dinamike në krijimin e drejtimeve të reja të studimit akademik;
9. Pjesëmarrje aktive në projekte ndërkombëtare (rritje kapacitetesh—Erasmus+);
10. Pjesëmarrje e konsiderueshme në projekte ndërkombëtare (bashkëpunim i gjerë në rang kombëtar e ndërkombëtar);
11. Organizim efektiv i praktikave profesionale, institucionale, në terren, klinike dhe sportive të studentëve, në fushat e edukimit, bujqësisë, ekonomisë, mjekësisë, shkencave sociale, etj;
12. Përfshirja e studentëve në vendimmarrje, si anëtarë me të drejta të plota në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës dhe Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;
13. Vlerësim periodik i cilësisë së brendshme;
14. Përvoja e fituar nga Qendrat e Ekselencës si njësi bazë kërkimore dhe trajnuese për formimin e vazhduar;
15. Mundësi botimi periodik i regjistruar i Buletin Shkencor.

Pikat e dobëta:

1. Rënie e theksuar e numrit të popullsisë të Rajonit të Korçës dhe si pasojë rënie e numrit të nxënësve në Institucionet e Arsimit të Ulët dhe të Mesëm (rreth 29% më pak nxënës në periudhën 2016-2020). Kjo rënie reflektohet në prurjet e studentëve në programet e studimit.
2. Prirje e përgjithshme e maturantëve në disa programe të caktuara studimi;
3. Cilësia jo e kënaqshme në hyrje e studentëve në disa programe studimi;

4. Stanjacion kualifikimi i pedagogëve me tituj shkencorë;
5. Pamundësi për të ofruar programe doktorature në cikël të tretë (studime doktorale) dhe vonesë në hapjen e programeve të ciklit të tretë Master ekzekutiv;
6. Mobilitete të kufizuara për studentë, staf akademik dhe administrativ. Mungesa e njohurive të thelluara në gjuhë të huaj nga stafi akademik në tërësi;
7. Sferë e ngushtë aplikimesh në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare nga të gjithë fakultetet;
8. Mungesa e bibliotekës digjitale dhe shfrytëzim i limituar i bibliotekave të fakulteteve;
9. Mungesa e një mjedisi të përshtatshëm sportiv për lëndë kurrikulare dhe aktivitete jashtë kurrikulare;
10. Mungesa e një databaze të plotë për punësimin e studentëve të diplomuar në vite dhe gjallërimi i lidhjeve të vazhdueshme me ta;
11. Mosshfrytëzim në efikasitet të plotë të laboratorëve dhe pajisjeve të përfuara kryesisht me fonde projektsh;
12. Stanjacion botimesh në Buletinin e Universitetit "Fan S. Noli";
13. Mungesë e një strategjie të plotë të promovimit të ofertës akademike;
14. Bashkëpunim i kufizuar me palët e interesit në tregun rajonal dhe më gjerë.

Mundësitë:

1. Vendndodhja e Universitetit "Fan S. Noli" në rajonin juglindor të Shqipërisë dhe në kufi me dy shtete ballkanike ofron mundësi për përthithjen e studentëve të rajonit dhe më gjerë, si dhe për shkëmbimi përvojash në fushën e edukimit dhe kërkimit shkencor;
2. Kapacitete njerëzore dhe infrastrukturore për hapjen e programeve master ekzekutiv;
3. Përvojë bashkëpunimi me IAL të huaja për hapjen e programeve të përbashkëta, për rritjen e mobiliteteve, krijimin e qendrave kërkimore dhe pasurimin e tyre me literaturë si dhe ndërkombëtarizimin e ofertës akademike; anëtarësim në rrjete ndërkombëtare akademike;
4. Shtrirja e gamës së moduleve që ofron Qendra e Formimit të vazhduar edhe në fusha të tjera përveç mësuesisë;
5. Staf akademik në prag kualifikimi në ciklin pasardhës të kualifikimit shkencor;
6. Proceset integruese, projektet e përbashkëta në të cilat është përfshirë Universiteti "Fan S. Noli", krijojnë mundësi të mëdha për zgjerimin e bashkëpunimit me institucione brenda e jashtë rajonit dhe më gjerë, në fushën e mësimdhënies e kërkimit shkencor.

Kërcënimet:

1. Rënia e përgjithshme e numrit të lindjeve dhe si rrjedhim i numrit të maturantëve që diplomohen në arsimin e mesëm të lartë;
2. Cilësia e ulët e kandidatëve-studentë në hyrje që vijnë nga shkollat e mesme profesionale;
3. Mungesa e një harte programesh në rang kombëtar dhe mosrankimi kombëtar i IAL-ve shqiptare;
4. Mungesa e një strategjie kombëtare të prirjes profesionale të kualifikimeve në të ardhmen;
5. Ndryshimet në përcaktimet buxhetore të fondit për arsimin e lartë;
6. Mungesa e një tregu të gjerë punësimi në nivel rajonal, mungesa e të dhënave mbi punësimet në nivel rajonal e më gjerë krijon vështirësi në orientimin e programeve të studimit dhe në përcaktimin e kuotave në çdo program.

PLANI I DETAJUAR I OBJEKTIVAVE

11.

OBJEKTIVAT

OBJEKTIVAT KRYESORË TË ZHVILLIMIT STRATEGJIK

1. Organizimi institucional;
2. Mësimdhënia, kurrikulat, stafi akademik, sigurimi i brendshëm i cilësisë;
3. Infrastruktura, shërbime, promocioni;
4. Kërkimi shkencor dhe inovacioni;
5. Ndërkombëtarizimi i ofertës akademike;
6. Studentët.

1. ORGANIZIMI INSTITUCIONAL

Në kuadër të zhvillimit të mëtejshëm institucional dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve që ofron Universiteti “Fan S. Noli”, parashikohet:

- Konsolidimi i mëtejshëm i sektorëve të miratuar tashmë në organigramën e Universitetit “Fan S. Noli”;
- Rritja dhe mbështetja e veprimtarisë së Njësisë së Brendshme të sigurimit të cilësisë;
- Konsolidimi i strukturave të kërkimit shkencor dhe botimeve akademike edhe në nivel njësie kryesore;
- Rritjen e veprimtarisë së Sektorit të Promocionit dhe Sektorit të Karrierës dhe Alumni;
- Standardizimin e veprimtarisë së Sektorit të Studimeve dhe TIK;
- Zgjerimin e fokusit të Sektorit të Projekteve dhe Kërkimit Shkencor;
- Rritjen e gamës së moduleve të të mësuarit gjatë gjithë jetës të ofruara nga Qendra e Formimit të Vazhduar.

2. MËSIMDHËNIA, KURRIKULAT, STAFI AKADEMIK, SIGURIMI I BRENDSHËM I CILËSISË

● MËSIMDHËNIA DHE KURRIKULAT

Në lidhje me mësimdhënien, në vitet akademike që pasojnë do të synohet kryerja e një sërë provimesh me kompjuter (alternativa). Qëllimi i provimeve në kompjuter është objektiviteti në vlerësim dhe transparenca.

Fillimisht provimet me kompjuter do të realizohen në disa lëndë të Programeve të Studimit të Ciklit të Parë: “Bachelor” në “Infermier i Përgjithshëm”, “Bachelor” në “Mami” dhe “Bachelor” në “Teknologji Informacioni”. Në vitet në vazhdim kjo do të shtrihet dhe në programe studimit të tjera që ofron universiteti “Fan S. Noli”.

Një objektiv tjetër për vitet e ardhshme akademike është dhe konsolidimi i metodave të reja të mësimdhënies, sidomos për mësimin online.

Në lidhje me programet e studimit synohet:

- Hapja e programeve të reja të studimit, në veçanti programet që mbyllin ciklet e studimit (programet e ciklit të dytë që janë vazhdimësi e programeve të ciklit të parë);
- Hapja e Programeve të Studimit të Ciklit të Tretë (Master Ekzekutiv);
- Hapja e programeve të përbashkëta të studimit me institucione ndërkombëtare;
- Përmbushja e detyrimeve ligjore për të gjitha programet e studimit në kuadër të akreditimit të tyre sipas përcaktimeve ligjore, si dhe plotësimet e rekomandimeve të lëna nga Bordi i Akreditimit për çdo program studimi;
- Përforcimi i kurrikulave aktuale;
- Studime tregu të mirëfillta (në mënyrë që të dhënat të përdoren për promocionin, si edhe për tërheqjen e maturantëve);
- Zgjerimi i fokusit të kualifikimeve sipas nevojave të tregut;
- Nxitja e aplikimit të gjetjeve shkencore në veprimtaritë mësimore;

Një pjesë të rëndësishme të Programeve të Studimit të Ciklit të Parë që mbulon universiteti “Fan S. Noli”, janë programet e profilit të mësuesisë. Në universitetin tonë zhvillohen 9 programe studimi (bachelor) të këtij profili:

1.	“Bachelor” në “Matematikë-Informatikë”
2.	“Bachelor” në “Matematikë-Fizikë”
3.	“Bachelor” në “Biologji-Kimi”
4.	“Bachelor” në “Filozofi-Sociologji”
5.	“Bachelor” në “Gjuhë-Letërsi”
6.	“Bachelor” në “Histori-Gjeografi”
7.	“Bachelor” në “Gjuhë-Angleze”
8.	“Bachelor” në “Mësues për Arsimin Parashkollor”
9.	“Bachelor” në “Mësues për Arsimin Fillor”

Qarku i Korçës ka rreth 300 Institucione të Arsimit Parashkollor, Arsimit Fillor dhe të Arsimit të Mesëm. Ky numër i lartë tregon rëndësinë që kanë programet e studimit të profilit të mësuesisë në universitetin tonë.

Në 4 vitet e fundit këto programe studimi kanë pasur një ulje shumë të ndjeshme të numrit të studentëve. Faktorët që kanë ndikuar në këtë fenomen janë kryesisht: mesatarja e kandidatëve, mbingopja e tregut të punës dhe rënia e numrit të nxënësve në shkollat e Arsimit Fillor dhe të Mesëm.

Strategjia e universitetit tonë gjatë periudhës 2020-2027 për konsolidimin e programeve të mësuesisë, do të jetë e bazuar në katër pikat që vijojnë:

- **Kontakt i vazhdueshëm me nxënësit e Arsimit të Mesëm**

Kjo do të realizohet nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, duke përfshirë në to dhe nxënës të Arsimit të Mesëm të Lartë nga i gjithë qarku Korçë dhe jo vetëm.

- **Olimpiada “Rroke Shkencën”**

Kjo olimpiadë zhvillohet midis nxënësve të shkollave të Arsimit të Mesëm të Lartë të Qarkut Korçë. Në themel të kësaj olimpiadë është puna në grup e nxënësve (5 nxënës përfaqësues nga çdo shkollë e mesme). Në 4-vjeçarën e ardhshëm do të shtojmë disa profile brenda olimpiadës, në mënyrë që të përfshihen shumica e profileve të programeve të studimit të mësuesisë të universitetit tonë. Pikërisht, profilet e olimpiadës do të jenë: matematikë, informatikë, fizikë, biologji, kimi, gjuhë-letërsi dhe shkencë sociale. Olimpiada do të administrohet nga departamentet përkatëse të profileve dhe duke përfshirë studentë të këtyre programeve të studimit.

- **Trajnime të ndryshme të nxënësve të Arsimit të Mesëm nga stafi Akademik i universitetit**

Në periudhën janar-maj të çdo viti, nga ana e stafit Akademik të universitetit do të bëhen trajnime të shkurtra për nxënësit maturantë të Arsimit të Mesëm të Lartë, në shërbim të provimeve të lirim. Me anë të këtyre trajnimeve, synohet qasja e nxënësve të shkollave të mesme në Universiteti “Fan S. Noli”.

- **STAFI AKADEMIK**

Në vitet në vazhdim, për stafin akademik të universitetit synohet:

- Konsolidimi i raportit staf akademik i brendshëm/i jashtëm;
- Nxitja e mëtejshme e kualifikimit të stafit akademik për marrjen e titujve dhe gradave shkencore;
- Nxitja e stafit akademik për konsolidimin e kërkimit shkencor dhe aplikimin e gjetjeve në veprimtaritë mësimore;
- Nxitja e stafit akademik për pjesëmarrje në programe apo projekte me interes të përbashkët.

- **SIGURIMI I BRENDSHËM I CILËSISË**

Sa i përket sigurimit të cilësisë universiteti fokusohet në dy ndarje: sigurimi i brendshëm i cilësisë dhe sigurimi i jashtëm i cilësisë. Universiteti e ka zhvilluar tashmë sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, i cili e mbështet veprimtarinë e tij në tre shtylla: *sigurimi, kontrolli dhe vlerësimi* i cilësisë. Pjesë e këtij sistemi është edhe Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, e cila mbështet dhe ofron ekspertizë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë përfshin marrjen e masave për përmblylljen e proceseve të akreditimit institucional dhe akreditimin e programeve të studimit.

Strategjia e universitetit tonë gjatë periudhës 2020-2027 për sigurimin e cilësisë mbështetet në këto objektiva kryesore:

- Realizimi i vlerësimit të cilësisë për akreditimin institucional dhe vlerësimi për akreditimin e programeve të studimit;
- Marrja e masave për proceset e akreditimit institucional dhe akreditimin e programeve të studimit
- Përbushja e standardeve për sigurimin e cilësisë;
- Kontrolli dhe rritja e cilësisë nëpërmjet veprimeve dhe masave të përshtatshme;
- Sigurimi i cilësisë së shërbimeve dhe infrastrukturës.

3. INFRASTRUKTURA, SHËRBIME, PROMOCIONI

● INFRASTRUKTURA

Në lidhje me infrastrukturën e Universitetit, synohet:

- Krijimi i ambienteve të nevojshme për konsolidimin e raportit student/m²;
- Krijimi i laboratorëve në shërbim të mësimdhënies;
- Vënia në funksion i laboratorit të fizioterapisë;
- Rinovimi me literaturë të nevojshme i bibliotekave të fakulteteve dhe bibliotekës së rektoratit.
- Ndërtimi i një godine shtesë në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane (mbi themelet e godinës ekzistuese të bibliotekës).

● SHËRBIME

Një nga objektivat kryesorë në vitin akademik 2021-2022 është dhe sekretaria mësimore e ristrukturuar. Kjo përfshin shkriren e të gjitha sekretarive në 4 fakultetet e universitetit, dhe krijimi i një sekretarie mësimore qendrore dhe i një sekretarie të sistemit qendrore. Brenda kësaj strukture studentët do të marrin të gjitha shërbimet e nevojshme (vërtetime, pagesa, etj).

Një objektiv tjetër është dhe krijimi i një website të ri të universitetit, në të cilin studentët dhe të interesuarit do të marrin çdo informacion në lidhje me programet e studimit dhe mbarëvajtjen e studimeve dhe të vitit akademik aktual.

● PROMOCIONI

Promocioni si një proces komunikimi midis asaj që universiteti ofron dhe studentëve potencialë duhet të konsiderohet si një pjesë e rëndësishme e institucionit për të rritur prurjet sasore dhe cilësore të studentëve. Për të rritur efikasitetin e aktiviteteve promovuese, universiteti do të bazohet në këto objektiva bazë, të cilat do të përkthehen në veprimtari konkrete:

- Hartimi i strategjisë institucionale të promocionit;
- Përfshirja aktive e njësive bazë;
- Përfshirja e aktorëve të tregut;
- Përfshirja e studentëve aktualë dhe atyre të diplomuar;

- Ngritja e bordit këshillimor;
- Përditësimi i materialeve promovuese;
- Organizimi i veprimtarive promovuese për prezantimin sa më të mirë të asaj që universiteti ofron.

4. KËRKIMI SHKENCOR DHE INOVACIONI

Në përcaktimin e objektivave strategjike në fushën e kërkimit, Universiteti “Fan S. Noli” merr parasysh, parimin e lirisë së kërkimit, parimin e etikës kërkimore, parimin e përgjegjshmërisë profesionale, detyrimeve ligjore dhe përgjegjësisë financiare, parime, të cilat e orientojnë veprimtarinë kërkimore në të mirë të njerëzimit dhe zgjerimit të kufijve shkencorë. Kjo synon përmirësimin e përmbajtjes së kërkimit shkencor me fokus mësimdhënien cilësore, përshtatjen me përparësitë kombëtare dhe rritjen e aftësisë së kërkimit të pavarur në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm.

Përafrimi i objektivave institucionalë me ato kombëtarë në sektorin e kërkimit dhe teknologjisë, në aspekte që lidhen me cilësinë e kërkimit, infrastrukturën kërkimore-shkencore, kërkimin e zbatuar në nivel shoqëror, lidhjen e kërkimit më mësimdhënien.

- Synimi parësor i kërkimit shkencor në Universitetin “Fan S. Noli” është rritja e cilësisë së mësimdhënies, duke i konsideruar gjetjet e tij, pjesë integrale e kualifikimeve të ofruara nga kurrikula universitare.
- Kërkimi shkencor konsiderohet gjithashtu pjesë e promovimit të stafit akademik, si hulumtues dhe inovator, në një kontekst më të gjerë, shoqëror dhe ekonomik, rajonal kombëtar dhe ndërkombëtar.

Prioritete të kërkimit shkencor:

- Rritja e veprimtarisë hulumtues në njësitë kryesore dhe standardizimi i tij me parimet e etikës së kërkimit;
- Rritja e veprimtarisë botues të stafit akademik (mbështetje financiare e botimeve ndërkombëtare);
- Përfshirja e studentëve në kërkim;
- Lidhja e kërkimit shkencor me kurrikulën dhe kualifikimet universitare;
- Nxitja e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar në kërkim të aplikuar;
- Rritja e ndikimit të UNIKO në rajon, si institucion që ofron ekspertizë të specializuar në fushat e bujqësisë, edukimit, ekonomisë, shkencave natyrore, humane dhe atyre të shëndetit në mbështetje të përparësive kombëtare;
- Vënia e plotë në punë e kapaciteteve të strukturës kërkimore në njësitë përkatëse, për të mundësuar shërbime të kualifikuara ndaj të tretëve.

5. NDËRKOMBËTARIZIMI I OFERTËS AKADEMIKE

Mbështetja te partneriteti ndërkombëtar në mësimdhënie dhe në kërkim, si dhe rritja e formave të bashkëpunimit me institucione simotra apo me rrjete institucionale të arsimit të lartë, në drejtim të pranisë ndërkombëtare në kërkimin dhe mësimdhënien që zhvillohet në institucion, në botimet që realizohen nga stafi akademik, si dhe shkëmbimet në kuadër të periudhave të studimit dhe mësimdhënies.

Aktualisht Universiteti "Fan S. Noli" numëron 127 marrëveshje aktive me institucione partnere në Ballkan dhe në Evropë. Ky universitet është pjesë e rrjeteve universitare ASCEC, AUF, UNIMED, AURORA CDS, BALKAN UNIVERSITY ASSOCIATION.

Marrëveshjet e bashkëpunimit:

Gjatë periudhës 2016-2020 u nënshkruan 120 marrëveshje bashkëpunimi të cilat paraqiten më poshtë:

1 28 marrëveshje ndërkombëtare me universitete të huaja me objektiva kryesorë:

- pjesëmarrja në veprimtari shkencore organizuar nga secili universitet;
- organizimi i përbashkët i veprimtarive shkencore;
- shkëmbimi i materialeve shkencore, librave midis studiuesve, bibliotekave etj;
- realizimi i publikimeve të përbashkëta;
- shkëmbimi i eksperiencës midis stafit akademik, administrativ dhe studentëve;
- pjesëmarrje e përbashkët në projekte të ndryshme;
- krijimi i mundësive për ofrimin e programeve të përbashkëta të studimit;
- shkëmbimi kulturor, etj.

2 35 marrëveshje kombëtare me Universitete (11), shoqata, organizata, qendra, institute, institucione të ndryshme (24) me objektiva kryesorë:

- nxitja e shkëmbimeve gjithëpërfshirëse në funksion të zhvillimit institucional dhe ndërinstitutional;
- shkëmbimi i stafit akademik për procesin mësimor;
- shkëmbimi i pedagogëve, studiuesve dhe studentëve në kuadrin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore;
- inkurajimi, mbështetja dhe implementimi i projekteve të përbashkëta kërkimore; promovimi, mbështetja dhe zbatimi i veprimtarive të tjera shkencore (konferenca, seminare dhe botime në fusha me interes të përbashkët);
- shkëmbimi i literaturës shkencore; shkëmbimi i librave, botimeve shkencore, projekteve akademike dhe informacionit mbi kurset, konferencat, seminarët dhe bazat e të dhënave me interes të përbashkët;
- nënshkrimi i kontratave të përbashkëta të botimit, nëse ka një interes të përbashkët për publikimin e rezultateve të kërkimit të mbuluara në këto Marrëveshje Mirëkuptimi; organizimi i veprimtarive të përbashkëta sociale dhe kulturore;
- shkëmbimi i përvojës në lidhje me menaxhimin e institucionit, etj.

3 57 marrëveshje kombëtare me qëllimin kryesor realizimin e praktikave studentore.

Këto marrëveshje janë nënshkruar me institucione, organizata dhe biznese të ndryshme sipas profilit të programeve të studimit që Universiteti "Fan S. Noli" ofron dhe sipas nevojës për praktikat studentore. Pjesa më e madhe e tyre janë nënshkruar në rang fakulteti lidhur ngushtë me profilin e fakulteteve dhe me profilin e institucioneve/bizneseve me të cilat janë lidhur marrëveshjet. Objektivat kryesorë të këtyre marrëveshjeve janë:

- krijimi i mundësive reale për studentët e Universitetit “Fan S. Noli” për kryerjen e praktikës profesionale pranë këtyre institucioneve/organizatave/bizneseve;
- organizimi dhe angazhimi në projekte dhe aktivitete të përbashkëta në shërbim të zhvillimit rajonal;
- realizimi i leksioneve, tryezave të rrumbullakëta, seminareve trajnuese me drejtuesit dhe specialistët e këtyre institucioneve dhe me pjesëmarrjen e studentëve;
- shkëmbimi i eksperiencës dhe ekspertizës;
- ofrimi i mjediseve të secilës palë në kuadër të kërkimit dhe studimit, me në fokus angazhimin e studentëve në kërkim shkencor;
- afrimi i studentëve me tregun e punës, duke lehtësuar punësimin e tyre në të ardhmen nëpërmjet kontaktit që krijohet paraprakisht midis organizatave/institucioneve/bizneseve punëdhënëse dhe Universitetit/studentëve me anë të ndërveprimit gjatë praktikave profesionale;
- çdo veprimtari tjetër me interes të përbashkët.

Objektivi kryesor i sa më sipër është krijimi i një profili besueshmërie dhe profesionalizimi në lidhje me mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në kuadër të projekteve të zhvillimit dhe rritjes së kapaciteteve njerëzore në mënyrë të ndërsjellë.

Drejtimet bazë

1. Partneritet dhe bashkëpunim konkret ndërkombëtar;
2. Programe studimi të përbashkëta dhe mobilitete afatgjata;
3. Kërkim i përbashkët shkencor sipas standardeve ndërkombëtare.

Ndërkombëtarizimi i ofertës akademike në pesë vitet e ardhshme synon promovimin e kësaj të fundit në një rrjet më të gjerë akademik, duke pasur si qëllim nxitjen e partneritetit konkret kryesisht në rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor, në qëndrueshmërinë e diplomave të ofruara në një treg më ndërkombëtar, promovimin dhe rritjen e vizibilitetit të arritjeve akademike të stafit dhe studentëve, nëpërmjet botimeve cilësore institucionale, organizimit të veprimtarive të përbashkëta shkencore, pjesëmarrjes në projekte-ide me qëllim rritjen e kapaciteteve institucionale dhe ndikimin e drejtpërdrejtë të tyre në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të rajonit.

Spektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si strukturë administrative mbështetëse, krijon hulli të reja të shkëmbimit ndëruniversitar, nëpërmjet:

- identifikimit të IAL-ve prioritare të bashkëpunimit;
- thellimit dhe diversifikimit të bashkëpunimit të UNIKO me partnerë strategjikë në Ballkan dhe Evropë, në drejtim të sa më sipër;
- nxitjen e shkëmbimit të studentëve, kërkuesve dhe mësimdhënësve në kuadër mobilitetesh;
- koordinimin e proceseve të ofrimit të diplomave të dyfishta;
- anëtarësimin në rrjete akademike dhe forcimit të pozitive në rrjetet tashmë anëtare ASEC, AUF, UAMID;
- aplikimit në projekte Erasmus +, Horizont 2020, CBC, Mari Curie Scholarships, Bursa Fullbright, etj;

- Koordinimi i procedurave për krijimin e qendrave të përbashkëta studimore dhe kërkimore;
- Rritja e komunikimit me diasporën akademike, alumni dhe ish-staf akademik, tashmë të punësuar në institucione ndërkombëtare të arsimit të lartës.

1 Programe studimi të përbashkëta dhe mobilitete afatgjata

Ofrimi i programeve të përbashkëta të studimit, me fokus kryesor ciklin e dytë dhe të tretë, synon rritjen e cilësisë së kualifikimit të ofruar nga kurrikula, qëndrueshmërinë e diplomave të ofruara në një treg më të gjerë të hapësirës evropiane, si dhe promovimin e përvojës akademike të stafit.

- studime të thelluara të kualifikimeve profesionale në tregun ndërkombëtar, me fokus profesionet e të ardhmes;
- nxitja e bashkëpunimit ndërinstitucional, në fusha të përbashkëta akademike që përputhen me sa më sipër;
- identifikimi i kapaciteteve reale në çdo njësi kryesore për programet e përbashkëta dhe kërkimin e zbatuar;
- përditësimi i Katalogut të Lëndëve Erasmus+ në dispozicion të studentëve të huaj dhe nxitja e mobiliteteve;
- detajimi i kuadrit ligjor dhe financiar që lehtëson procedurat e njohjes dhe transferimit të krediteve dhe mobilitetet staf/studentë;
- hartimi i programeve ndërkombëtare/ trajnime/ shkolla verore afatshkurtra kualifikimi për staf, studentë, alumni, palë të interesuara.

2 Kërkim i përbashkët shkencor sipas standardeve ndërkombëtare

- nxitja e organizimit të veprimtarive të përbashkëta shkencore ndërkombëtare; standardizimi i procedurave dhe dokumentacionit të tyre;
- hartimi i politikave stimuluese për pjesëmarrjen e stafit dhe studentëve në veprimtari kërkimore jashtë vendit;
- krijimi i qendrave të përbashkëta kërkimore, studimore dhe përditësimi i fondit të literaturës së vënë në dispozicion të stafit kërkimor;
- rritja e cilësisë së Buletinit Shkencor, nëpërmjet zgjerimit të Bordit të tij shkencor me anëtarë nga universitetet partnere; botimi i tij në gjuhën angleze dhe aplikimi për indeksim ndërkombëtar;
- nxitja e botimeve shkencore në revista me indeks të njohur ndërkombëtar;
- përfshirjen e studentëve në kërkim dhe krijimin e urave lidhëse me partnerët ndërkombëtarë për organizimin e veprimtarive shkencore;
- përfshirja e mësimdhënies online në kurrikulën universitare dhe rritja e programeve që ofrohen në formën e "blended learning/ mësimdhënia e ndërthurur";
- nxitja e hapësirave/kualifikimit mbi sipërmarrjen dhe inovacionin në kurrikulën universitare.

6. STUDENTËT

Universiteti synon të krijojë një mjedis sa më frymëzues për studentët aktualë dhe për ata që pritet të vijnë në të ardhmen, duke ofruar cilësi dhe angazhim profesional që përmbush pritshmëritë më të mira të tyre. Në këtë drejtim, universiteti do të bazohet në disa objektiva kryesore:

- Përmirësimi i shërbimeve në mbështetje të studentit për të rritur cilësinë e studimeve dhe jetës studentore;
- Krijimi i një mjedisi frymëzues pune dhe mësimi, duke u përqendruar te mësimdhënia me në qendër studentin, si një mënyrë për të fuqizuar studentin në të gjitha format e edukimit, duke ofruar zgjidhjen më të mirë për rrugë të të mësuarit të qëndrueshëm dhe fleksibël;
- Organizimi i veprimtarive të cilat janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me studentët dhe rritja e cilësisë së jetës shoqërore dhe artistike të studentëve;
- Zgjerimi i rrjetit Alumni dhe mbledhja e të dhënave për mbarëvajtjen profesionale të individëve që kanë kryer studimet në Universitetin “Fan S. Noli” dhe organizimi i veprimtarive dhe takimeve me studentët e diplomuar.

12.

REZULTATET E PRITSHME NGA OBJEKTIVAT

1. PLAN I REZULTATEVE TË PRITSHME NGA OBJEKTIVAT

- VEPRIMTARIA MËSIMORE DHE VLERËSIMI I CILËSISË

OBJEKTIVI		PLAN VEPRIMI
Objektivi 1	Hapja e programeve të reja të studimit, në veçanti programet që mbyllin ciklet e studimit (programet e ciklit të dytë që janë vazhdimësi e programeve të ciklit të parë)	Hapja dhe përmirësimi i programeve të ciklit të dytë.
		Hapja e Programeve të Studimit të Ciklit të Tretë (Master Ekzekutiv).
		Ofrimi i programeve të studimit të përbashkëta, me fokus kryesor ciklin e dytë dhe të tretë.
		Nxitja e bashkëpunimit ndërinstitucional në kuadër të programeve të studimit të përbashkëta.
	Hapja e programeve të përbashkëta të studimit me institucione ndërkombëtare	Hartimi i programeve ndërkombëtare/ trajnime/ shkolla verore afatshkurtra kualifikimi për staf, studentë, alumni, palë të interesuara.
Objektivi 2	Përbushja e detyrimeve ligjore për të gjitha programet e studimit në kuadër të	Realizimi i vlerësimit brendshëm të cilësisë për akreditimin institucional dhe vlerësimi për akreditimin e programeve të studimit.

	akreditimit të tyre sipas përcaktimeve ligjore		Marrja e masave për proceset e akreditimit institucional dhe akreditimin e programeve të studimit. Plotësimet e rekomandimeve të lëna nga Bordi i Akreditimit për çdo program studimi.
Objektivi 3	Përforcimi i kurrikulave aktuale	Ristrukturimi, përmirësimi dhe ndryshimi i vazhdueshëm i kurrikulës	Unifikimi i formateve të rregulloreve të programeve të studimit dhe i syllabuseve, për modulet e lëndëve përkatëse në çdo program.
			Ristrukturimi i programeve në përmbushje të kërkesave të tregut të punës.
			Riorganizimi i programeve të ciklit të parë, të dytë me qëllim rritjen e rezultateve të të nxënësve dhe profilet e të diplomuarve edhe në raport me nevojat e individëve dhe shoqërisë.
		Konsolidimi i programeve të mësuesisë	Kontakt i vazhdueshëm me nxënësit e Arsimit të Mesëm. Olimpiada “Rroke Shkencën” Trajnime të ndryshme të nxënësve të Arsimit të Mesëm nga stafi Akademik i Universitetit.
Objektivi 4	Studime tregu të mirëfillta	Zgjerimi i fokusit të kualifikimeve sipas nevojave të tregut	Përdorimi i të dhënave për ristrukturimin e programeve ose për hapjen e programeve të reja. Standartizimi i të dhënave të nevojshme për promocionin.
Objektivi 5	Nxitja e mëtejshme e kualifikimit të stafit akademik për marrjen e titujve dhe gradave shkencore		Nxitja e kualifikimit të stafit akademik në përmirësimin e aftësive pedagogjike për t’iu afruar standardeve për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Europiane të AL.

		Nxitja e aplikimit të gjetjeve shkencore në veprimtaritë mësimore	Rritja dhe përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Përdorimi i metodologjive të reja.
Objektivi 6	Përmbushja e standardeve të sigurimit të cilësisë	Kontrolli dhe rritja e cilësisë nëpërmjet veprimeve dhe masave	Ecuria e procesit mësimor, në përputhje me planet dhe programet në të gjithë përbërësit e tij.
			Konsolidimi i metodave të reja të mësimdhënies, sidomos për mësimin online.
			Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të kompetencave të fituara, si edhe matja e rezultateve të nxënësve.
			Përfshirja e studentëve në sigurimin e cilësisë.

2. PLAN I REZULTATEVE TË PRITSHME NGA OBJEKTIVAT

- KËRKIMI SHKENCOR

OBJEKTIVI		PLAN VEPRIMI	
Objektivi 1	Rritja e veprimtarisë hulumtuese në njësitë kryesore dhe standardizimi i tij me parimet e etikës së kërkimit	Standardizimi i veprimtarisë kërkimore	Hartimi i Rregullores së kërkimit shkencor, në rang institucional.
			Hartimi i Kodit të Etikës së Kërkimit Shkencor dhe hartimi i standardeve të kërkimit shkencor.
			Hartimi i kritereve të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore të stafit akademik.
			Aplikimi i platformës së kërkimit, si bazë të dhënash qendrore, informative dhe promovuese e kërkimit shkencor.
			Sesione trajnimi mbi integritetin shkencor dhe përgjegjësinë profesionale të kërkuesve.
			Aplikimi i një sistemi informatik për parandalimin e plagjaturës në kërkim.
			Mbështetja dhe përmirësimi i infrastrukturës shkencore brenda njësisë.
			Mbështetja financiare me grante për kërkimin falë projekteve institucionale, kombëtare dhe ndërkombëtare.
			Rritja e kapaciteteve të zyrës së kërkimit dhe projekteve
		Rritja e veprimtarisë hulumtuese në institucion	Rritja e bashkëpunimit me institucione kërkimore brenda dhe jashtë vendit.
			Nxitja e organizimit të veprimtarive shkencore të përvitshme.

			<p>Nxitja e kërkimeve të përbashkëta në fusha interesi me staf dhe studentë në universitetet partnere.</p> <p>Promovimi i gjetjeve të kërkimit në palët e interesit.</p> <p>Digjitalizimi i fondit të bibliotekës qendrore.</p> <p>Katalogimi i fondit të bibliotekës.</p> <p>Rritja e gamës së abonimeve në biblioteka online.</p> <p>Rritja e volumit të literaturës së printuar dhe asaj elektronike në bibliotekën universitare.</p>
Objektivi 2	Rritja e aktivitetit botues të stafit akademik	Rritja e cilësisë së aktivitetit botues të stafit akademik	<p>Ristrukturimi i Buletinit shkencor UNIKO me synim indeksimin e tij kombëtar dhe gjithëpërfshirjen në rang institucional.</p> <p>Ngritja e Bordit Shkencor Botues dhe miratimi i kritereve për botime akademike në rang institucional.</p> <p>Përcaktimi i procedurave të botimit dhe promocionit të botimeve të teksteve universitare.</p> <p>Nxitja e bashkëpunimeve me ente botuese/ institute kërkimore</p>
Objektivi 3	Përfshirja e studentëve në kërkim	Rritja e aktivitetit dhe përfshirjes studentore në kërkim	<p>Organizimi i veprimtarive me fokus kërkimin studentor.</p> <p>Promovimi i kërkimit studentor me anë të botimeve.</p> <p>Krijimi i bazës së të dhënave të punimeve të diplomës në rang institucional.</p>

			<p>Nxitja e cilësisë së hulumtimit në bibliotekë dhe rritja e frekuentimit të kësaj të fundit.</p> <p>Rivitalizimi i Qendrës së Inovacionit.</p> <p>Nxitja e publikimit të revistave online me qëllim promovimin e veprimtarisë kërkimore të studentëve.</p>
Objektivi 4	Lidhja e kërkimit shkencor me kurrikulën dhe kualifikimet universitare	Nxitja e kërkimit shkencor me bazë kurrikulën, rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mobiliteteve	<p>Aplikim për programe të ciklit të tretë (diploma të përbashkëta).</p> <p>Vënia në funksion e Qendrës së Studimeve Ndërdisciplinore/ rritja e bashkëpunimit me njësi të ngjashme në rajon/ mbështetja e ideve inovative të aplikimit të kërkimit në kurrikul.</p> <p>Nxitja e veprimtarive me karakter kërkimor që synojnë rritjen e cilësisë së mësimdhënies (botim i teksteve universitare).</p> <p>Rritja e numrit të mobiliteteve mësimdhënëse për stafin akademik dhe mirëpritja e mobiliteteve nga institucionet bashkëpunuese.</p> <p>Nxitja e organizmit të veprimtarive me karakter kërkim i aplikuar.</p>
Objektivi 5	Nxitja e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar në kërkim të aplikuar	Rritja e kapaciteteve të stafit	<p>Nxitja e aplikimeve në projekte ndërkombëtare në kuadër Erasmus+, Horizon 2020, Jean Monnet, CBC, etj.</p> <p>Nxitja e pjesëmarrjes së stafit në shkrimin e projekteve.</p> <p>Nxitja e mobiliteteve dhe inkurajimi i shkëmbimit të risive.</p>

			Përditësimi i Katalogut Erasmus+.
Objektivi 6	Rritja e ndikimit të UNIKO në rajon	Rritja e ndikimit të ekspertizës së specializuar të UNIKO në rajon, në fushat e bujqësisë, ekonomisë, shkencave natyrore dhe shkencave humane, në mbështetje të përparësive kombëtare	Përfshirja e ekspertizës akademike në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve të caktuara rajonale.
			Përcaktimi i kritereve të kërkimit aplikativ në projekte me fonde institucionale.
			Përfshirja e stafit në projekte rajonale.
			Rritja e bashkëpunimit me institucionet e tregut.
			Rritja e kapacitetit kërkimor të laboratorëve dhe stafit përgjegjës.
Objektivi 7	Vënia në efikasitet të plotë e kapaciteteve të strukturës kërkimore në njësitë përkatëse	Vënia në efikasitet të plotë e kapaciteteve të strukturës kërkimore në njësitë përkatëse, për të mundësuar shërbime të kualifikuara ndaj të tretëve	Krijimi i programeve të përbashkëta të bashkëpunimit me biznesin nëpërmjet formave të transferimit të teknologjive.
			Trajnimi i stafit përgjegjës për shfrytëzimin e plotë të kapaciteteve laboratorike.
			Investime në përditësimin e funksioneve laboratorike me qëllim kërkimin dhe krijimin e bazave të të dhënave.

3. PLAN I REZULTATEVE NGA OBJEKTIVAT

- NDËRKOMBËTARIZIMI I OFERTËS AKADEMIKE

OBJEKTIVI			PLANI I VEPRIMIT
Objektivi 1	Rritja e kapaciteteve të Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë	Shndërrimi në strukturë administrative mbështetëse që krijon mundësi të reja të shkëmbimit ndëruniversitar	Identifikimi i institucioneve prioritare të bashkëpunimit akademik.
			Thëllimi dhe diversifikimi i bashkëpunimit të UNIKO me partnerë strategjikë në Ballkan dhe Evropë, në drejtimet e mësipërme. Anëtarësimi në rrjete akademike dhe forcimi i pozitive në rrjetet tashmë anëtare ASEC, AUF, UAMID. Nxitja e shkëmbimit të studentëve, kërkuesve dhe mësimdhënësve në kuadër mobilitetesh. Koordinimi i proceseve të ofrimit të diplomave të dyfishta. Lehtësimi i procedurave të aplikimi në projekte Erasmus +, Horizont 2020, CBC, Mari Curie Scholarships, Bursa Fullbright, etj.. Koordinimi i procedurave për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta studimore dhe kërkimore. Rritja e komunikimit me alumni dhe ish-staf akademik, tashmë të punësuar në institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë.
Objektivi 2	Programe studimi të përbashkëta dhe mobilitete afatgjata	Ofrimi i programeve të studimit të përbashkëta, me fokus kryesor ciklin e	Studime të thelluara të kualifikimeve profesionale në tregun ndërkombëtar, me fokus profesionet e të ardhmes. Nxitja e bashkëpunimit ndërinstytucional, në fusha të

		dytë dhe të tretë	<p>përbashkëta akademike që përputhen me sa më sipër.</p> <p>Identifikimi i kapaciteteve reale në çdo njësi kryesore për programet e përbashkëta dhe kërkimin e zbatuar.</p> <p>Detajimi i kuadrit ligjor dhe financiar që përcakton dhe lehtëson procedurat e njohjes dhe transferimit të krediteve dhe mobilitetet staf/studentë.</p> <p>Hartimi i programeve ndërkombëtare/ trajnime/ shkolla verore afatshkurtra kualifikimi për staf, studentë, alumni, palë të interesuara.</p>
Objektivi 3	Kërkim i përbashkët shkencor sipas standardeve ndërkombëtare	Nxitja e iniciativave të përbashkëta në fushën e kërkimit	<p>Nxitja e organizimit të veprimtarive të përbashkëta shkencore ndërkombëtare; standardizimi i procedurave dhe dokumentacionit të tyre.</p> <p>Diskutimi i politikave stimuluese për pjesëmarrjen e stafit dhe studentëve në aktivitete kërkimore jashtë vendit.</p> <p>Përditësimi i fondit të literaturës së vënë në dispozicion të stafit kërkimor.</p> <p>Rritja e cilësisë së Buletinit Shkencor, nëpërmjet zgjerimit të Bordit të tij shkencor me anëtarë nga universitetet partnere; botimi i tij në gjuhën angleze dhe aplikimi për indeksim ndërkombëtar.</p> <p>Nxitja e botimeve shkencore në revista me indeks të njohur ndërkombëtar.</p> <p>Përfshirja e studentëve në kërkim dhe krijimin e urave lidhëse me partnerët ndërkombëtarë për</p>

			<p>organizimin e veprimtarive shkencore.</p> <p>Përfshirja e mësimdhënies online në kurrikulën universitare dhe rritja e programeve që ofrohen në formën e “blended learning/ mësimdhënia e ndërthurur”.</p> <p>Nxitja e hapësirave/kualifikimit mbi sipërmarrjen dhe inovacionin në kurrikulën universitare.</p>
--	--	--	---

4. PLAN I REZULTATEVE TË PRITSHME NGA OBJEKTIVAT

● INFRASTRUKTURA, PROMOCIONI DHE STUDENTËT

Objektivi 1	Sigurimi i cilësisë së shërbimeve dhe infrastrukturës	Krijimi i ambienteve të nevojshme dhe krijimi i laboratorëve në shërbim të mësimdhënies	Zhvillimi i mekanizmave për cilësinë e mësimdhënies.
			Vënia në funksion i laboratorit të fizioterapisë.
			Rinovimi me literaturë të nevojshme i bibliotekave.
Objektivi 2	Hartimi i strategjisë institucionale të promovimit dhe ngritja e Bordit Këshillimor	Përfshirja aktive e njësisë bazë dhe e aktorëve të tregut dhe krijimi i materialeve promovuese	Përgatitja e planveprimit për ditët e promovimit të Universitetit “Fan S. Noli”.
			Riorganizimi i guidave dhe fletëpalosjeve.
			Diskutime me sektorin publik dhe privat
		Organizimi i veprimtarive promovuese për prezantimin sa më të mirë të asaj që universiteti ofron	Pjesëmarrja në panaire.
			Rishikimi dhe përditësimi i të dhënave dhe publikimeve në faqen zyrtare të internetit.
Objektivi 3	Përmirësimi i shërbimeve në mbështetje të studentit për të rritur cilësinë e studimeve dhe jetës studentore	Krijimi i një mjedisi frymëzues pune dhe mësimi	Fokusimi në mësimdhënien me në qendër studentin, si një mënyrë për të fuqizuar studentin në të gjitha format e edukimit, duke ofruar zgjidhjen më të mirë për rrugë të të mësuarit të qëndrueshëm dhe fleksibël.
			Krijimi i lidhjeve të forta mes stafit dhe studentëve.
		Organizimi i veprimtarive të cilat janë të lidhura në	Përforcimi i rolit të Qendrës së Karrierës dhe i rolit të Këshillit Studentor.

		mënyrë të drejtpërdrejtë me studentët dhe rritja e cilësisë së jetës shoqërore dhe artistike të studentëve	Mbështetja për përmbushjen e veprimtarive të Këshillit Studentor dhe zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta.
			Trajnimi për “Modulin e Karrierës” dhe prezantime për orientimin e studentëve të viteve të para për rregulloren dhe studimet në Universitetin “Fan S. Noli”.
Alumni		Zgjerimi i rrjetit <i>Alumni</i>	Mbledhja e të dhënave për mbarëvajtjen profesionale të individëve që kanë kryer studimet në Universitetin “Fan S. Noli”.
			Organizimi i veprimtarive dhe takimeve me studentët e diplomuar, dhënia e referencave për studime dhe punësim, angazhimi në projektet e universitetit, publikimi i punimeve shkencore etj.
			Nxjerrja e të dhënave nga rrjeti <i>Alumni</i> me qëllim përshtatjen e programeve të studimit me nevojat e tregut të punës.
			Organizimi i ditës <i>Alumni</i> Universiteti “Fan S. Noli”.
			Përditësimi i databazës <i>Alumni</i> .



www.unkorce.edu.al